

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje dru zjarri”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

“Blerje dru zjarri”-03413000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit : 2.082.600 (dy milion e tete dhjete e dy mije e gjashte qind) leke pa t.v.sh ,i ndare si me poshte:

-Fondi limit per cerdhet eshte : 249.600 (dy qind e kater dhjete e nente mije e gjashte qind) leke pa t.v.sh.

-Fondi limit per kopshtet eshte 1.833.000 (nje milion e tete qind e tri dhjete e tre mije) leke pa t.v.sh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2 dhe pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Kapacitetin profesional te operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete te paisur me Licence leshuar nga QKL kodi III.7.A sipas objektit qe prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licenca bazë për shitjen e lendes drusore dhe perpunimin e tij, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.

2.1.2 Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2023 (ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik dhuhet te paraqitet vecmas per secilin OE).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77, pika 5 të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për per vitin 2021 ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 , ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqeruara me akt-ekspertizë të ekspertit kontabel , ku bilancet e **dy viteve të njëpasnjëshme**, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatimit Taksave).

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për

tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqese deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.
- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara,
 - Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon të paktën 5 punonjës ku 1 prej tyre duhet të jene me emertesen **specialist perpunimi druri** te shoqeruar me certifikaten perkatese duhet të paraqesë listë pagesen e deklaruar përmes formës elektronike per tre muajt e fundit nga momenti i zhvillimit te tenderit, ku te specifikohet numri i punonjesve.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne piken 4 te nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në funksion të sa më sipër minimalisht nevojiten: 1 shoferë, 1 punetor qe ngarkon shkarkon, 1 magazinier dhe 1 ekonomist, 1 specialist perpunim druri.*

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon nje mjete transporti , ne pronësi ose ne perdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës .

Operatori ekonomik pjesmarres duhet të paraqes dokumentacionin që disponon mjetin e transportit kamion jo me pak se 3.5 ton , ne pronësi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie.
- akt kolaudimi,
- policen e sigurmit te mjetit
- taksen vjetore
- lejen e transportit nga komuna apo bashkia per vete ose te trete.

Argumentimi: *Arsyeja përse është kërkuar automjeti eshte marre se malli qe do te dorezohet ne magazine e Drejtorise Cerdhe dhe Kopshte do te shperndahet ne gjithe kopshtet e cerdhet e Bashkise Shkoder me Njesite Administrative qe ndodhen ne kete bashki,sipas nje plan shperndarje te miratuar nga A.K*

2.3.4 Ofertuesi te kete kontrate furnizimi me dru dhe duhet te paraqese kontraten e furnizimit ku te jete përcaktuar sasia dhe afati i kontrates shoqeruar me Licence leshuar nga QKL kodi III.7.A te furnizuesit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licenca bazë për shitjen e lendes

drusore dhe perpunimin e tij, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.

2.3.5 Ofertuesi do të paraqes deshmi kualifikimi për të paktën 1 punëtor të specializuar në fushën e perpunimit të drurit jo më pak se një vit të leshuar me certificate nga DRFP.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

2.3.6 Kur Ofertuesi ka kontratë furnizimi për furnizim me dru nga jashtë Shqipërisë duhet të paraqes kontratën e furnizimit të perkthyer në gjuhën shqip dhe noterizuar.

2.3.7 Një makinë transporti të shoqëruara me (leje qarkullimi), akt kolaudimi, policën e sigurimit të mjetit, taksat si edhe lejen e transportit nga komuna apo bashkia për vetë ose të tretë të pershtatshme për transportin e druve..

Argumentimi: *Arsyeja përse është kërkuar automjeti është marrë se malli që do të dorëzohet në magazine e Drejtorisë Cerdhe dhe Kopshte do të shpërndahet në gjithë kopshtet e cerdhet e Bashkisë Shkoder me Njesitë Administrative që ndodhen në këtë bashki sipas një plan shpërndarje të miratuar nga A.K*

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë vendodhjen e mallit në mënyrë që të verifikohet nga Autoriteti Kontraktor si dhe të paraqes dokumentacionin e nevojshëm në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të bindet që sasia e mallit e kërkuar është e depozituar.

Argumenti :

A.K duhet të bindet tek serioziteti dhe korrektesia e operatorit ekonomik pjesëmarrës se i ka gjithë kapacitetin e nevojshëm për ofrimin e kësaj sasive malli që kërkohe.

- *Operatorët ekonomikë ofertues që kanë patur marrëdhënie kontraktuale të mëparshme me Bashkinë Shkoder dhe të cilët kanë rezultuar me mospërbushje të suksesshme të objektivit dhe detyrimeve përkatëse të kontratës , do të skualifikohen.*

Argumenti :

Ky kriter ka për bazë përbushjen e kontratave të mëparshme me korrektesinë dhe respektimin të marrëdhënieve kontraktuale.

- *Operatori ekonomik ofertues nuk duhet të ketë detyrime të papaguara vendore, detyrime të ngarkuara nga organet kompetente audituese apo detyrime të ngarkuara nga organe të tjera në favor të Bashkisë Shkoder dhe të Njesive Administrative (ish Komuna që i janë bashkuar Bashkisë Shkoder). Mospërbushja e këtij kriteri është shkak skualifikimi. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.